

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 20, datë 24.03.2004**

**Për**  
**Miratimin e rregullores "Mbi kredinë brenda ditës"**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Kontabilitetit dhe Pagesave, në bazë të nenit 43, germa "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë",

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë rregulloren "Mbi kredinë brenda ditës", bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të autorizojë Zëvendësguvernatorin e Parë të miratojë "Udhëzimin për procedurat e kredisë brenda ditës" që do të rregullojë marrëdhëniet midis njësive të Bankës së Shqipërisë, në zbatim të kësaj rregulloreje.
3. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave, Departamenti i Operacioneve Monetare, si dhe bankat e nivelit të dytë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave për dërgimin e këtij vendimi në bankat e nivelit të dytë.
5. Ngarkohet Departamenti Marrëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**  
**Ylli MEMISHA**

**KRYETARI**  
**Shkëlqim CANI**

## KËSHILLI MBIKËQYRËS

### R R E G U L L O R E

#### “MBI KREDINË BRENDË DITËS”.

Miraturar me vendimin nr.20, datë 24.03.2004, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Tiranë, 2004

#### Neni 1

#### Mbështetja ligjore

Në bazë dhe për zbatim të neneve 15,16,19 dhe 21 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, miraton rregulloren “Mbi kredinë brenda ditës”.

Kjo rregullore është në përputhje dhe në zbatim të :

“Rregulla dhe procedura të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare AIPS”.

“Rregullore për kredinë njëditore”.

Rregullores “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë”.

#### Neni 2

#### Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të lejojë dhënien e kredisë brenda ditës nga Banka e Shqipërisë për bankat e nivelit të dytë me qëllim plotësimin e nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit ndërbankar të pagesave AIPS, në përputhje me vendimet dhe me objektivat e miratuara të politikës monetare.

#### Neni 3

#### Përkufizime

Në funksion të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kuptojnë:

**Sistemi AIPS** është Sistemi Shqiptar i Pagesave Ndërbankare (Albanian Interbank Payment System – AIPS).

**Kredi brenda ditës**- Kredi me afat më të vogël se një ditë pune.

Mobilizimi i rezervës së detyruar- **përdorimi i një pjese të shumës së rezervës së detyruar për shlyerjen e veprimeve në llogaritë rezervë, masa maksimale ditore e të cilës përcaktohet nga rregullorja “Për minimumin e rezervës së detyruar”.**

**Tepricë minimale** - Shuma e detyruar e tepricës së llogarisë së bankës, e cila përcaktohet nga rregullorja “Për minimumin e rezervës së detyruar”.

**Rezerva të lira-** fondet e disponueshme në tepricën e llogarisë së bankës nga e cila është zbritur teprica minimale.

**Cut-Off Paraprak-** afati maksimal i përcaktuar në kalendarin e sistemit AIPS për pranimin e pagesave për klientët.

**Cut-Off Përfundimtar-** afati maksimal i përcaktuar në kalendarin e sistemit AIPS për pranimin e pagesave nga pjesëmarrësit.

#### **Neni 4**

#### **Kredia brenda ditës dhe linja e kreditit**

Banka e Shqipërisë u jep bankave të nivelit të dytë kredi brenda ditës për shlyerjen e pagesave në AIPS, brenda linjës së kreditit të përcaktuar për secilën bankë, bazuar në aktmarrëveshjen e lidhur për këtë qëllim.

Linja e kreditit për një bankë, përcaktohet në bazë të vlerës së mjeteve që banka ka ngurtësuar si kolateral, në përputhje me metodat e vlerësimit të përcaktuara për kredinë njëditore, në rregulloren “Mbi garancitë në operacionet e kreditimit të Bankës së Shqipërisë”.

Kur një bankë vendos një mjet si kolateral për kredi, Banka e Shqipërisë çel/shton një linjë krediti për atë bankë, pasi ka marrë garancinë për ngurtësimin e mjeteve që do të përdoren si kolateral.

Mjetet e ngurtësuara si kolateral shërbejnë si garanci jo vetëm për kredinë brenda ditës, por edhe për operacionet e tjera kredituese të Bankës së Shqipërisë - instrumente të politikës monetare.

#### **Neni 5**

#### **Dhënia e kredisë brenda ditës.**

Kredia brenda ditës jepet vetëm në lekë (monedha ALL).

Kredia brenda ditës është pa interes.

Mjetet e ngurtësuara si kolateral janë letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare.

Një bankë që dëshiron të përfitojë kredi brenda ditës përcakton listën e letrave me vlerë të vlefshme si kolateral dhe e dërgon atë në Bankën e Shqipërisë ( sipas formatit të paraqitur në shtojcën 1, e cila është pjesë integrale e kësaj rregulloreje). Është përgjegjësi e secilës bankë, administrimi dhe përditësimi i këtij portofoli të ngurtësuar.

Banka e Shqipërisë bën vlerësimin e kolateralit dhe përcakton, në bazë të këtij vlerësimi, linjën e kreditit.

Linja e re e kreditit hyn në fuqi dy ditë pune pas dërgimit në Bankën e Shqipërisë të garancisë së përcaktuar në pikën 5.4.

Banka e Shqipërisë akordon qysh në fillim të ditës së punës në AIPS, shumën totale të kredisë brenda ditës që banka mund të përfitojë brenda linjës së vet të kreditit.

## **Neni 6**

### **Kthimi i kredisë brenda ditës.**

Çdo bankë e nivelit të dytë është përgjegjëse për administrimin e likuiditetit të vet gjatë ditës së punës, duke monitoruar në AIPS tepricën e llogarisë, masën e mobilizimit të rezervës së detyruar dhe masën e përdorimit të kredisë brenda ditës.

Banka duhet të sigurojë fondet e mjaftueshme në llogari, me qëllim kthimin e kredisë brenda ditës në afatin midis 'cut-off-it paraprak' dhe atij 'përfundimtar' në AIPS.

Pas 'cut-off-it paraprak', transaksionet e kthimit të kredisë brenda ditës shlyhen automatikisht ose, në rast pamjaftueshmërie të fondeve, vendosen në radhën e pritjes me prioritet maksimal. Për pasojë, asnjë pagesë e iniciuar nga banka nuk mund të shlyhet pa u kthyer fondet e përdorura të kredisë brenda ditës.

## **Neni 7**

### **Moskthimi i kredisë brenda ditës**

Në qoftë se, kthimi i kredisë brenda ditës nuk ka përfunduar deri 15 minuta pas cut-off përfundimtar të AIPS, Banka e Shqipërisë akordon kredi njëditore automatike, për shumën e pambuluar.

## **Neni 8**

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 20, datë 24.03.2004 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi menjëherë pas botimit në buletin zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS  
Shkëlqim CANI**

## SHTOJCA 1

[EMRI I BANKËS ], [KIB]

jep këtë

### GARANCI

për përmbushjen e detyrimeve që [EMRI I BANKËS] ka ose mund të ketë kundrejt Bankës së Shqipërisë, në përputhje me rregulloret e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, i nënshkruari ngurtëson si kolateral në favor të Bankës së Shqipërisë, letrat me vlerë të mbajtura për llogari të [EMRI I BANKËS] si më poshtë:

| Nr. | Data e emetimit | Nr.ankandit | Data e maturimit | Shuma |
|-----|-----------------|-------------|------------------|-------|
| 1.  |                 |             |                  |       |
| 2.  |                 |             |                  |       |
|     |                 |             |                  |       |
|     |                 |             |                  |       |
|     | Totali          |             |                  |       |

Kjo garanci lëshohet në dy kopje, prej të cilave një mbahet nga Banka e Shqipërisë dhe një nga [EMRI I BANKËS].

Tiranë, më \_\_\_\_\_

Për [EMRI I BANKËS]

[NËNSHKRIMET]

Garancia e mësipërme është pranuar

Tiranë, më \_\_\_\_\_

Për BANKËN E SHQIPËRISË

[NËNSHKRIMET]

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 21, datë 24.03 . 2004**

**Për**

**Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës” miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43 germa c të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” :

**V E N D O S I :**

1. Në udhëzimin “Për kapitalin rregullator të bankës”, miratuar me vendimin nr. 57, datë 05.05.1999 dhe ndryshuar me vendimin nr. 40, datë 16.05.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, miratohen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtëme :
  - 1.1. Në kapitullin II, pas pikës 3.2. shtohet pika 3.3 me këtë përmbajtje :

“3.3. Të gjitha zbritjet e parashikuara në aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë (V).  
TOTALI I KAPITALIT RREGULLATOR ËSHTË [ C+J - (P+Q+V)].”
  - 1.2. Formulari i raportimit ndryshohet sipas formës bashkëngjitur.
  - 1.3. Pjesa e formularit të raportimit nr.2 tek rregullorja “Për risqet e tregut” nga pika I deri tek pika IV ndryshohet sipas pikës së mësipërme 1.2. të këtij vendimi.
  - 1.4. Në kapitullin II, pika 6 ndryshohet si vijon :
6. REZERVAT :

Rezervat, me përjashtim të rezervave të rivlerësimit, krijohen nga shpërndarja e fitimit të bankës pas tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendëve. Ato krijohen :

me vendim të organeve vendimmarrëse,  
në respektim të rregullave të brendshëm të bankës të miratuar nga organet vendimmarrëse,  
në respektim të kuadrit ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Në rezerva përfshihen këto kategori :

- 6.1 Rezerva ligjore të krijuara nga respektimi i akteve ligjore në fuqi.
- 6.2. Rezervat statutore të krijuara nga respektimi i statutit të bankës.
- 6.3. Rezervat e rivlerësimit, që përfaqësojnë kundëpartinë e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme në kuadër të rivlerësimit me vendim të organeve vendimmarrëse dhe/ose të respektimit të akteve ligjore.
- 6.4. Rezervat e tjera, që përfaqësojnë të gjitha rezervat e krijuara nga shpërndarja e fitimit me përjashtim të rezervave të pikës 6.1. dhe 6.2..
- 6.4.1. Rezervat e përgjithshme janë pjesë e rezervave të tjera, që përmbushin kushtet e mëposhtme:  
përdoren lirisht nga banka për mbulimin e rreziqeve të paidentifikuara lidhur me aktivitetin e bankës dhe nuk reflektojnë reduktimin e vlerës të një aktivi të caktuar,  
figurojnë në kontabilitetin e bankës,  
shuma përcaktohet nga drejtuesit dhe verifikohet nga komiteti i kontrollit të bankës dhe nga eksperti kontabël i autorizuar.
3. Vendimi nr. 40, datë 16.05.2001 i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave për zbatimin e këtij vendimi duke bërë të gjitha shtesat dhe ndryshimet përkatëse në formularët ku parashikohen zbritjet sipas rregulloreve përkatëse.
5. Ngarkohet Departamenti i Marëdhënieve me Publikun në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**  
**Ylli MEMISHA**

**KRYETARI**  
**Shkëlqim CANI**

FORMULARI I RAPORTIMIT  
(kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë)

Emri i bankës ....  
 Periudha raportuese .....  
 Data e raportimit .....  
 Përgatiti (Emër,mbiemër,firmë)  
 Drejtuesi (Emër,mbiemër,firmë)

në mijë Lekë.

|   | KAPITALI BAZË   | Nr.llog.      |    | Shuma |
|---|---|---------------|----|-------|
|   | I . Elementet përbërëse që shtohen (A) :              |               |    |       |
| 1 | Kapitali i nënshkruar                                 | 5711          |    |       |
| 2 | Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)           | 5731,57335734 |    |       |
| 3 | Primet e emetimit dhe të fuzionimit                   | 572           |    |       |
| 4 | Fitimet e pashpërndara (e bartura)                    | 577(P)        |    |       |
| 5 | Fitimi ushtrimor i fundit të vitit                    | 578(P)        |    |       |
| 6 | Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese               | 578(P)        |    |       |
| 7 | Diferenca rivlerësimi kreditore                       | 574(P)        |    |       |
|   |   |               |    |       |
|   | Nëntotali A= ( 1+2+3+4+5+6+7 )                        |               | A  |       |
|   |   |               |    |       |
|   | II . Elementet përbërëse që zbriten (B) :             |               |    |       |
| 1 | Kapitali i nënshkruar i papaguar                      | 5712          |    |       |
| 2 | Vlera nominale e aksioneve (të pashitura, të riblera) |               |    |       |
| 3 | Humbjet e pashpërndara ( të bartura )                 | 577(-P)       |    |       |
| 4 | Humbja ushtrimore                                     | 578(-P)       |    |       |
| 5 | Diferenca rivlerësimi debitore (negative)             | 574(-P)       |    |       |
| 6 | Aktive <sup>1</sup> të qëndrueshme të patrupëzuara    | 531           |    |       |
|   |   |               |    |       |
|   | Nëntotali B= ( 1+2+3+4+5+6 )                          |               | B  |       |
|   |   |               |    |       |
|   | Totali i kapitalit bazë C= ( A-B )                    |               | C  |       |
|   |   |               |    |       |
|   | KAPITALI SHITESË                                      |               |    |       |
|   | III . Elementet përbërëse (J) :                       |               |    |       |
| 1 | Rezervat e rivlerësimit                               | 5732          | EA |       |
| 2 | Rezerva të përgjithshme                               |               | EB |       |
| 3 | Instrumente hibride                                   | 56            | EC |       |

<sup>1</sup> sipas Manualit të Kontabilitetit Bankar duhet të zëvendësohet me fjalën “mjete”.



|    |  |    |    |  |
|----|--|----|----|--|
| 4  | Detyrime të varura me afat   | 56 | F  |  |
|    | N.q.s. $F \leq C/2$ atëherë $G = F$  |    | G  |  |
|    | N.q.s. $F > C/2$ atëherë $G = C/2$   |    | G  |  |
|    |  |    |    |  |
|    | Nëntotali i kufizuar $H = (EA + EB + EC + G)$ :  |    | H  |  |
|    | Kufizimi i parë: n.q.s. $H \leq C$ atëherë $J = H$   |    | J  |  |
|    | Kufizimi i dytë: n.q.s. $H > C$ atëherë $J = C$  |    | J  |  |
|    |  |    |    |  |
|    | Totali i kapitalit shtesë para zbritjes (J)  |    | J  |  |
|    |  |    |    |  |
|    | IV. Elementet përbërëse që zbriten (P +Q+V):   |    |    |  |
| 1  | Pjesëmarrje në banka e institucione financiare (P):  |    |    |  |
| -- | Pjesëmarrje mbi 10 për qind në kapitalin e tyre ose nën 10 për qind por që ushtron një ndikim të rëndësishëm mbi to duke shtuar edhe të drejtat e varura në të njëjtën bankë ose institucion financiar .   |    | K  |  |
| -- | Shuma e pjesëmarrjeve, që nuk plotësojnë kushtet e mësipërme, së bashku me të drejtat e varura të tjera ndaj të njëjtave banka ose institucione financiare u zbriten 10 për qind të fondeve të veta (C+J) :  |    | L  |  |
|    | Për shembull $M = (C+J) \cdot 10\%$  |    | M  |  |
| -- | Mbetur pas zbritjes : $N = (L - M)$ n.q.s. është pozitive .  |    | N  |  |
|    | Nëntotali $P = (K+N)$  |    | P  |  |
| 2  | Garancitë e dhëna fondeve të garancive reciproke sipas kushteve të bankës qendrore.  |    | Q  |  |
| 3  | Aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë (V):  |    |    |  |
| -- | rregullorja "Për administrimin e rrezikut të kredisë", miratuar me vendimin nr.13, datë 21.02.01 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.  |    | V1 |  |
| -- | rregullorja "Për investimet nga bankat në kapitalin e shoqërive tregtare", miratuar me vendimin nr.42, datë 06.06.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.  |    | V2 |  |
| -- | rregullorja "Për madhësinë dhe plotësimin e kapitalit fillestar minimal për veprimtaritë e lejuara të bankave dhe të degëve të bankave të huaja të licencuara", miratuar me vendimin nr.51, datë 22.04.99 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. |    | V3 |  |
| -- | akte të tjera rregullative.  |    | Vn |  |

|    |   |  |         |  |
|----|---|--|---------|--|
|    | totali i akteve rregullative:<br>$V = (V_1 + V_2 + V_3 + V_n)$                    |  | V       |  |
|    |   |  |         |  |
|    | Nëntotali i pjesës që zbritet është $(P+Q+V)$                                     |  | $P+Q+V$ |  |
|    |   |  |         |  |
|    | Llogaritja përmbledhëse e kapitalit bazë dhe e kapitalit shtesë pas zbritjes IV : |  |         |  |
|    |   |  |         |  |
| 1  | N.q.s. $J \leq (P+Q+V)$ atëherë :   |  |         |  |
| -- | Kapitalit shtesë pas zbritjes $JA = 0$  |  | JA      |  |
| -- | Kapitalit bazë $CA = C + J - (P+Q+V)$   |  | CA      |  |
| 2  | N.q.s. $J > (P+Q)$ atëherë :  |  |         |  |
| -- | Kapitalit shtesë pas zbritjes $JA = J - (P+Q+V)$                                  |  | JA      |  |
| -- | Kapitalit bazë $CA = C$   |  | CA      |  |
|    |   |  |         |  |
|    | Totali i kapitalit bazë dhe i kapitalit shtesë :<br>$E = (JA + CA)$               |  | E       |  |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 22, datë 24.03.2004**

**Për**

**“Miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit””.**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, në bazë të nenit 43, gërma “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë ndryshimet në rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit”, miratuar me vendimin nr. 58, datë 05.05.1999, ndryshuar me vendimin nr. 72, datë 11.09.02, me vendimin nr. 86, datë 07.11.02, me vendim nr. 30, datë 16.04.2003 dhe me vendim nr. 82, datë 08.10.03 të Këshillit Mbikëqyrës, të Bankës së Shqipërisë, si më poshtë:

1. Në pikën 8 :

1.1 Shprehja “vendet e zonës A” zëvendësohet me shprehjen “vendet e OECD”.

1.2 Shprehja “vendet e zonës B” zëvendësohet me shprehjen “vendet që nuk bëjnë pjesë në OECD”.

1.3 Paragrafi 8.1.3, pika a) ndryshon si vijon:

“Hua që plotësojnë njëkohësisht karakteristikat e mëposhtme:

- kanë si objekt blerjen e një prone rezidenciale (shtëpi, apartament);
- kredimarrësi është blerësi i kësaj prone rezidenciale;
- janë të kolateralizuara në mënyrë të plotë me anë të një hipoteke mbi një pronë rezidenciale, e cila është në pronësi të kredimarrësit dhe është në përdorim ose jepet me qera prej tij.

2. Në pikën 12 :

2.1 Në pikën 12.1. lista e vendeve të zonës A zëvendësohet me listën e vendeve të OECD :

“Australia, Austria, Belgjika, Britania e Madhe, Kanadaja, Çekia, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Japonia, Korea, Luksemburgu, Meksiko, Holanda, Norvegjia, Polonia,

Portugalia, Sllovakia, Spanja, Suedia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zelanda e Re, Zvicra .”

- 2.2 Në pikën 12.2. shprehja “të gjitha vendet e tjera që nuk përmenden në këtë listë i përkasin zonës B” zëvendësohet me shprehjen “të gjitha vendet e tjera që nuk përmenden në këtë listë nuk bëjnë pjesë në OECD”.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve Publike në Bankën e Shqipërisë për publikimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**  
**Ylli MEMISHA**

**KRYETARI**  
**Shkëlqim CANI**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**V E N D I M**

**Nr. 23, datë 24.03.2004**

**Për**

**“ Lirimin nga detyra të Drejtorit të Departamentit të Emisionit  
në Bankën e Shqipërisë “.**

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi kërkesën e Drejtorit të Departamentit të Emisionit, në mbështetje të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “ Për Bankën e Shqipërisë “, neni 43, shkronja h

**V E N D O S I :**

1. Lirimin e z. Kamber Myftari, nga detyra e Drejtorit të Departamentit të Emisionit.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI  
Ylli MEMISHA**

**KRYETARI  
Shkëlqim CANI**

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 1, Janar 2004**

1. Vendim nr. 01, datë 28. 01. 2004. Për miratimin e “Raportit të zhvillimeve ekonomike dhe monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2003”
2. Vendim nr.02, datë 28.01. 2004. Për “Miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të pagesave ndërbankare -AIPS”.
3. Vendim nr.03, datë 28.01.2004. Për disa ndryshime në rregulloren “Mbi funksionimin e sistemit kontabël dhe të thesarit (ATM)” miratuar me vendimin nr. 75, datë 25.09. 2002.
4. Vendim nr.04, datë 28.01.2004. Për një ndryshim në rregulloren “Mbi funksionimin e shërbimit të sistemit SWIFT” miratuar me vendimin nr. 16, datë 01.03. 2000.
5. Vendim nr.05, datë 28.01. 2004. Për miratimin e një ndryshimi në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e rregullores “Mbi kriteret e vlerësimit të rezultateve në punë të punonjësve në Bankën e Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 2, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 06, datë 11.02. 2004. Për pajisjen me licencë për të ushtruar veprimtari bankare, të “Bankës Popullore” Sh.a.
2. Vendim nr. 07, datë 11.02. 2004. Për “Përcaktimin e pagës bazë të punonjësve të Bankës së Shqipërisë”.

### **Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 3, Shkurt 2004**

1. Vendim nr. 08, datë 25.02.2004. Për miratimin e “Raportit të Politikës Monetare për muajin janar të vitit 2004”
2. Vendim nr.09, datë 25.02.2004. Për miratimin e deklaratës të Bankës së Shqipërisë “Mbi kërcënimet e stabilitetit të sistemit financiar në Shqipëri”
3. Vendim nr. 10, datë 25.02.2004. Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave”.
4. Vendim nr.11, datë 25.02.2004 Për miratimin e udhëzimit “Mbi procedurat e nxjerrjes së urdhërzhdëmtimeve në Bankën e Shqipërisë”.
5. Vendim nr. 12, datë 25. 02. 2004. “Për miratimin e bilancit dhe për përdorimin e fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2003”.
6. Vendim nr.13, datë 25.02.2004. Për “Pezullimin dhe ndalimin e kryerjes së

disa veprimtarive të përfshira në aneksin e licencës së Bankës Italo-Shqiptare”.

**Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar Vëllimi 6, Numër 4, Mars 2004**

1. Vendim nr. 16, datë 10.03.2004. Për “Miratimin e fondit numizmatik të monedhave metalike e të kartëmonedhave shqiptare”.
2. Vendim nr. 17, datë 10. 03. 2004. “Për miratimin e disa ndryshimeve në Sistemin Raportues të Unifikuar”.